

SONILA BOÇI

Instituti i Historisë / Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë
sonilaboci23@gmail.com

**SHQIPËRIA DHE ITALIA NGA PËRFUNDIMI I LUFTËS
SË DYTË BOTËRORE DERI NË VENDOSJEN
E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE
(1945-1949)**

Abstrakt:

Shqipëria dhe Italia dolën nga Lufta e Dytë Botërore me status ndërkombëtar të paqartë. Shqipëria kishte qenë një prej viktimave të para të Boshtit. Rezistenca e shqiptarëve kundër ushtrive të Boshtit ishte njohur nga Aleatët e Kombeve të Bashkuara, por mungesa e një qeverie në mërgim¹ dhe mosnjohja ndërkombëtare e qeverisë provizore të dalë nga mbledhja II e Këshillit Nacionalçlirimtar në Berat nuk ishte një lajm i mirë për vijimësinë e shtetit shqiptar. Italia, nga ana tjetër, kishte qenë një nga shtetet e Boshtit, por angazhimi i italianëve gjatë viteve 1943-1944 në rezistencën kundër Gjermanisë së Hitlerit, i jepte në përfundim të luftës statusin e një vendi të mundur, për të cilin aleatët, veçanërisht ata perëndimorë ishin të gatshëm të bënin disa lëshime. E kontrolluar nga aleatët në shumë aspekte të politikës së saj të jashtme, Italia e pasluftës po përpiqej të rigjente vendin e saj në konfiguracionin gjeostrategjik europian. Vitet që artikulli merr në studim janë shumë të rëndësishme për të dyja vendet në ravijëzimin e qëndrimeve dhe politikave të tyre kundrejt njëra-tjetrës. Qëllimi i artikullit është të analizojë rrugëtimin e të dyja shteteve në përpjekje për të rivendosur marrëdhëniet diplomatike në një botë të dalë nga një konflikt i armatosur, që po ecte me shpejtësi drejt polarizimit ideologjik. Ai synon të argumentojë

¹ Përpjekje për krijimin e një qeverie në mërgim u bënë, qoftë nga Ahmet Zogu e Federata Panshqiptare “Vatra”, qoftë nga organizata “Shqipëria e Lirë”, por Aleatët e Mëdhenj Perëndimorë nuk e mbështetën njohjen e saj. Për më tepër mbi përpjekjet e emigracionit shqiptar për të krijuar qeveri në mërgim, shih: Hamit Kaba, *Nga lufta në paqe: Shqipëria dhe SHBA (1939-1946)*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë (Tiranë: Kristalina-KH, 2020).

se si pozicionimi i këtyre dy shteteve në të dy krahët opozitarë të Luftës së Ftohtë do të kondiciononte marrëdhëniet ndërmjet tyre.

Fjalë kyçe:

Riatdhesimi i italianëve, Traktati i Paqes me Italinë, rivendosja e marrëdhënieve, Lufta e Ftohtë.

Ndër vite, Italia kishte qenë një prej Fuqive të Mëdha, e cila kishte shfaqur një interes të veçantë për çështjen dhe shtetin shqiptar. Me vendimin e 9 nëntorit të vitit 1921, Konferenca e Ambasadorëve në Paris e njohu zyrtarisht pozitën e veçantë të Italisë në Shqipëri, pozicion që u materializua gjatë viteve 1925-1939, edhe për shkak të politikës që Ahmet Zogut ndoqi ndaj saj.² Sulmi italian ndaj Shqipërisë më 7 prill 1939 dhe aneksimi nga perandoria fashiste e Mussolini-t, tregoi qartazi interesin e imperializmit italian ndaj shtetit të vogël ballkanik.³

Viti 1945 i gjeti të dy fqinjët e Adriatikut në vështirësi jo të vogla. Italia ishte e ndarë në Veriun e Republikës së Saló-së të drejtuar nga Benito Mussolini dhe të pushtuar nga nazistët gjermanë dhe pjesës tjetër të kontrolluar nga Aleatët e Kombeve të Bashkuara. Një lëvizje e fuqishme rezistence antifashiste kundër pushtuesve filloi edhe në rajonet e Veriut, e cila drejtohej nga Komiteti për Çlirimin Kombëtar (Comitato di Liberazione Nazionale (CLN) në përbërje të të cilit ishin Partia Komuniste e Italisë (PKI), Partia e Aksionit (PA), Partia Socialiste (PSI), Partia Liberale (PLI), Partia Demokristiane (PDKI). Në radhët e tyre një peshë të madhe kishin komunistët, socialistët dhe Partia e Aksionit, të tria grupime të spektrit të majtë, gjë që do të krijonte shqetësim tek aleatët perëndimorë për një orientim politik të mundshëm të Italisë së pasluftës

² Për më shumë në lidhje me marrëdhëniet shqiptaro-italiane në vitet 1925-1939, shih: *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX (1925-1939)*, vëll. III, grup autorësh, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë (Tiranë: Kristalina-KH, 2020), 69-99; Arben Cici, *Marrëdhëniet shqiptaro-italiane në vitet 1920-1934* (Tiranë: UET Press, 2013).

³ Studiuesi italian Alberto Basciani mbron tezën se imperializmi i Benito Mussolini-t ishte vijim i politikës së ndjekur nga Italia e pasbashkimit. Shih: Alberto Basciani, *L'Impero nei Balcani, l'occupazione italiana dell'Albania (1939-1943)* (Roma: Viella, 2022), 13.

drejt së majtës.⁴ Në prill të vitit 1945, Republika e Saló-së u rrëzua nga presioni i rezistencës antifashiste. Mussolini, i njohur si Duce i fashizmit, u arrestua më 27 prill 1945 pranë fshatit Dongo, në bregun perëndimor të liqenit të Como-s nga partizanët italianë dhe të nesërmen u ekzekutua së bashku me 15 hierarkë të lartë fashistë.⁵

Gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore, Italia kishte njohur rrënimin ushtarak, politik, ekonomik, material, dhimbjen për mijëra jetë të humbura, të gjitha këto pasojë e aventurës së dështuar fashiste.⁶ Në përfundim të saj, Italia vijonte të kishte statusin e një prej shteteve aleate të Bllokut nazifashist, ndonëse këtë të fundit e kishte braktisur pas marrëveshjes së armëpushimit të 8 shtatorit të vitit 1943.⁷ Statusi si vend aleat i Boshtit nuk ndryshoi, as me vendimin e qeverisë së Badoglio-s më 14 tetor 1943 për t'i shpallur luftë ish-aleates së saj Gjermanisë.⁸ Nga qershori i vitit 1945, Italia drejtohej nga një qeveri koalicioni me pjesëmarrjen e të gjitha forcave politike që përbënin CLN-në dhe udhëhiqej nga socialdemokrati Ivanoe Bonomi. Vendi kontrollohej nga Aleatët e Kombeve të Bashkuara, pa miratimin e të cilëve, veçanërisht në politikën e jashtme, qeveria italiane nuk mund të ndërmernte asnjë hap.⁹

Këto zhvillime bënë që Italia të dalë nga Lufta e Dytë Botërore me statusin e një vendi të mundur, por për të cilin Aleatët e Mëdhenj ishin të gatshëm të bënin disa lëshime. SHBA-ja duke gjykuar se kriza e thellë ekonomike do të rriste ndikimin e PKI-së në shoqërinë italiane, nxiti përfshirjen e Italisë në programin e ndihmave të UNRRA-s. Po kështu, Italisë iu njoh e drejta të trajtohej si një prej fuqive-shoqe sa i takon Traktatit të Paqes me Gjermaninë.¹⁰ Për sa i përket politikës së saj ndaj Shqipërisë, Kryeministri Badoglio kishte deklaruar më 23 maj 1944 se

⁴ Pierre Milza, *Historia e Italisë nga origjina në ditët tona* (Tiranë: Dituria, 2012), 816.

⁵ *Po aty*, 814-816.

⁶ Për më shumë mbi gjendjen e Italisë në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, shih: *po aty*, 813.

⁷ Më shumë për marrëveshjen e armëpushimit midis Italisë dhe Aleatëve të Kombeve të Bashkuara, shih: Giuseppe Mammarella, *L'Italia contemporanea 1943-1998* (Roma: Il Mulino, 2000), 9-11.

⁸ *Po aty*, 26.

⁹ *Po aty*, 9; Settimo Stallone, *Prove di diplomazia adriatica: Italia e Albania (1944-1949)* (Torino: G. Giappichelli Editore, 2006), 34.

¹⁰ Council of Ministers, London, "Draft heads of treaty with Italy", 12 September 1945, in *Foreign Relations of United States* (më tej: *FRUS*), 1945, vol. II (Washington: United States Government printing office, 1968), 144.

Roma nuk ushqente më qëllime ekspansioniste se Italia do të mbështeste lindjen e një Shqipërie të lirë dhe të pavarur.¹¹ Të njëjtën gjë përsëriti edhe De Gasperi, ministri i Jashtëm italian, në një komunikim të tij me Sekretarin e Shtetit të SHBA-së, Byrnes, duke shtuar madje se “pavarësia e plotë e Shqipërisë, përbën një element më shumë në sigurinë dhe ekuilibrin e Adriatikut”.¹²

Shqipëria, ndonëse ishte një prej viktimave të para të Italisë së Mussolini-t, doli nga Lufta e Dytë Botërore si një shtet me status ndërkombëtar jo të qartë.¹³ Ajo nuk u ftua në Këshillin e Ministrave të Jashtëm në Londër për të parashtruar kërkesat e saj në lidhje me Traktatin e Paqes me Italinë.¹⁴ Për sa u takon marrëdhënieve me Italinë, historia kishte dëshmuar se ajo kishte arsye të dyshonte në synimet e politikës së jashtme italiane. Nga ana tjetër, politika e jashtme e qeverisë shqiptare të kohës do të përcaktohej, në një masë të madhe, nga konsideratat ideologjike. Në pranverë të vitit 1945, misioni ushtarak shqiptar në Bari informoi qeverinë shqiptare se forcat e majta politike në Itali ishin mjaft të fuqishme, por jodominante.¹⁵ I njëjti raport vinte në dukje se Italia ishte i vetmi treg i sigurt për disa nga prodhimet shqiptare, duke sugjeruar vendosjen e marrëdhënieve diplomatike sa më shpejt të mundej ndërmjet dy vendeve.¹⁶ Pritshmëria ndaj zhvillimeve të brendshme në Itali,

¹¹ S. Stallone, *Prove di diplomazia adriatica ...*, 21.

¹² *I Documenti Diplomatici Italiani* (më tej: *DDI*), Decima Serie: 1943-1948, vol. II (12 dicembre 1944-9 dicembre 1945) (Roma: Istituto Poligrafico e Zecca dello Stato, 1992), dok. nr. 446 (604-605). Ministri i Jashtëm italian për Sekretarin e Shtetit të SHBA-së, Romë, 22 gusht 1945.

¹³ Aleatët e Kombeve të Bashkuara kishin njohur rezistencën e shqiptarëve kundër fuqive të Boshtit, si dhe vullnetin e tyre për të restauruar pavarësinë e Shqipërisë, por pa pasur një marrëveshje në lidhje me kufijtë e saj. Mungesa e një qeverie shqiptare në mërgim, mosnjohja e qeverisë së përkohshme të drejtuar nga Enver Hoxha, mungesa e ftesës për të qenë të pranishëm në Konferencën e San Francisco-s, e bënte të ardhmen e Shqipërisë shumë të mjegullt. Mbi situatën ndërkombëtare të Shqipërisë në përfundim të Luftës së Dytë Botërore dhe në vitet e para pas saj, shih: Paskal Milo, *Të vërtetat e fshehura: incidenti i Kanalit të Korfuzit* (Tiranë: Toena, 2010), 37-53; H. Kaba, *Nga lufta në paqe ...*, 73-134.

¹⁴ *DDI*, X Serie, vol. II, dok. nr. 619 (839). Ambasadori italian në Moskë, Quaroni, për ministrin e Jashtëm, De Gasperi, Moskë, 12 tetor 1945.

¹⁵ *Arkivi i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme i Republikës së Shqipërisë*, Fondi MPJ (më tej: *AMPJ*), V. 1945, D. 32, fl. 4-6. Raport i Misionit Ushtarak Shqiptar në Bari për qeverinë shqiptare, 16 prill 1945.

¹⁶ *Po ajo*, fl. 21.

paqartësia për mbështetjen që kishte brenda vendit dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare, nevoja për të zgjeruar shkëmbimet tregtare do të përcaktonin, një lloj politike pritëse të qeverisë shqiptare edhe ndaj Italisë gjatë vitit 1945.

Pas konsolidimit të pushtetit me zgjedhjet e 2 dhjetorit, qeveria shqiptare e pozicionoi veten tërësisht në Lindje, gjë që ndikoi në ndërprerjen e kontakteve me qeverinë italiane.¹⁷ Veçanërisht pas largimit të ministrave të Partisë Komuniste Italiane nga qeveria e koalicionit të Alcide de Gasperi-t, në mars të 1947-s dhe fillimit të Luftës së Ftohtë, Italia dhe Shqipëria ishin dy vende fqinje, të cilat qëndronin në të dyja anët e barrikadës, duke përfaqësuar, në njëfarë mënyre, kufirin ndarës në detin Adriatik midis Perëndimit jokomunist dhe Lindjes komuniste. Kjo kushtëzoi marrëdhënie të tensionuara dhe aspak miqësore ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë gjatë viteve 1946-1949.

Tri ishin çështjet që, më së shumti, do të shqetësonin marrëdhëniet mes dy fqinjëve: nënshkrimi i traktatit të paqes me Italinë; riatdhësimi i italianëve të mbetur në Shqipëri dhe normalizimi i marrëdhënieve ndërshtetërore nëpërmjet vendosjes së marrëdhënieve diplomatike.

Traktati i Paqes me Italinë

Më 29 korrik 1946, në Paris filloi punimet Konferenca e Paqes, e cila do të diskutonte dhe do të përfundonte nënshkrimin e një traktati paqeje ndërmjet shteteve me Italinë, Bullgarinë, Rumaninë, Hungarinë dhe Finlandën. Shqipëria ishte në një pozitë aspak komode edhe sa i takon Traktatit të Paqes me Italinë. Nga njëra anë, ishte akuza greke për ekzistencën e gjendjes së luftës me Shqipërinë, si pjesë e argumenteve të Athinës zyrtare në mbrojtje të pretendimeve territoriale ndaj Shqipërisë së Jugut, parashtrimi i të cilave në Konferencë mbështetej nga Britania e Madhe dhe SHBA-ja. Në anën tjetër, edhe pse ishte një nga viktimat e para të agresionit fashist italian, *de jure* Shqipëria nuk kishte nënshkruar ndonjë akt që e vendoste në gjendje lufte me Italinë. Duke luajtur me tezhën e “bashkimit personal”, si dhe duke u përpjekur të argumentonin se

¹⁷ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 14/ Arkivi i Partisë (AP)-Organet Udhëheqëse (OU), Viti (më tej: V.) 1945, Dosja (më tej: D.) 4. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PKSH-së, 4 dhjetor 1945; *po aty*, 14/AP-OU, V. 1946, D. 1/1. Procesverbal i mbledhjes së Plenumit V të KQ të PKSH-së, 21 shkurt 1946.

investimet italiane në Shqipëri e kalonin shifrën e dëmeve të shkaktuara nga lufta,¹⁸ diplomacia italiane do të përpiquej të çlirohej nga barra e pagesës së dëmshpërblimeve kundrejt fqinjit të saj.

Pavarësisht këtij statusi ndërkombëtar të paqartë, qeveria shqiptare bëri të gjitha demarshet për t'u përfshirë në Traktatin e Paqes me Italinë. Më 4 shtator 1945, në prag të mbledhjes së Këshillit të Ministrave të Jashtëm në Londër, Tirana zyrtare iu drejtua me anë të një telegrami qeverive të SHBA-së, Britanisë së Madhe dhe Bashkimit Sovjetik, ku argumentonte të drejtën e shtetit shqiptar për të përfituar dëmshpërblime nga Italia.¹⁹

Përpilimi i Traktatit të Paqes me Italinë nxori në pah kontradiktat mes ish-Aleatëve të Kombeve të Bashkuara. Aleatët perëndimorë hodhën idenë se nuk duhej përpiluar një traktat paqeje ndëshkues për Italinë dhe dëmshpërblimet duhej të kufizoheshin në pasuritë që shteti italian kishte në shtetet e pushtuara. Në të kundërtën Bashkimi Sovjetik, së bashku me shtetet që e mbështesnin atë synonte një paqe ndëshkuese për Italinë.²⁰ Këtij qëndrimi iu bashkua edhe qeveria shqiptare. Memorandumi, i cili do t'i parashtronte Këshillit të Ministrave të Jashtëm dhe më pas Konferencës kërkesat e qeverisë shqiptare për çështjen e dëmshpërblimeve, restitucioneve etj., u përgatit me shumë kujdes nga qeveria shqiptare, në konsultim të vazhdueshëm me atë jugosllave dhe sovjetike. Që gjatë vitit 1945, ajo ngarkoi të gjitha ministrinë dhe institucionet e tjera shtetërore të përgatisnin lista mbi dëmet që pushtimi italian i kishte shkaktuar Shqipërisë, si dhe një listë me sendet me vlerë, të cilat ishin çuar në Itali gjatë këtyre viteve.²¹ Më 19 mars 1946, memorandumi i qeverisë shqiptare iu paraqit Këshillit të Ministrave të Jashtëm. Ai përmblihte një listë të gjatë e të detajuar mbi shkatërrimet e ndërtesave,

¹⁸ S. Stallone, *Prove di diplomazia adriatica ...*, 48.

¹⁹ "Dëmshpërblimet italiane të Luftës së Dytë Botërore për Shqipërinë (1945-1960)", në Hamit Kaba, *Shqipëria në rrjedhën e Luftës së Ftohtë (studime dhe dokumente)* (Tiranë: Botimpex, 2007), 121.

²⁰ Në Konferencën e Potsdamit, Bashkimi Sovjetik kishte kërkuar dëmshpërblime nga Italia që kapnin shifrën e 300 000 000 dollarëve amerikanë, pjesa më e madhe e të cilave do të përfitohej nga shteti i sovjetëve, dhe pjesa tjetër do të ndahej mes Jugosllavisë, Greqisë, Shqipërisë etj. Për më tepër shih: S. Stallone, *Prove di diplomazia italiana ...*, 154-155.

²¹ Për më shumë mbi përgatitjen e memorandumit të qeverisë shqiptare, shih: H. Kaba, "Dëmshpërblimet italiane të Luftës së Dytë Botërore për Shqipërinë (1945-1960)...", 121.

rrugëve e urave; dëmet në bujqësi dhe ekonomi etj. Shuma e dëmeve llogaritej në 684 214 792 dollarë amerikanë. Kësaj i shtohet dhe një shumë e konsiderueshme në formë restitucioneesh për arin e Bankës Kombëtare dhe veprave me rëndësi historike, arkeologjike e fetare, që ishin dërguar në Itali pas 7 prillit 1939.²² Shuma e përgjithshme e dëmshpërblimeve dhe restitucioneve që kërkonte qeveria shqiptare kapte shifrën e 3 544 332 000 franga ar (1 161 000 000 dollarë amerikanë).²³

Në të gjitha mbledhjet e Këshillit të Ministrave të Jashtëm, ku u hartua drafti i Traktatit të Paqes me Italinë, Shqipëria, e cila, jo vetëm për faj të saj, nuk ishte as anëtare e koalicionit e Kombeve të Bashkuara, as fuqi-shoqe, nuk ishte e ftuar të merrte pjesë. Gjithsesi Tirana “përfitoi” nga klima ndërkombëtare dhe rivaliteti që po shfaqej gjithmonë e më qartë ndërmjet ish-Aleatëve të Mëdhenj. Gjatë mbledhjeve të Këshillit të Ministrave të Jashtëm interesat e Shqipërisë u mbrojtën, jozyrtarisht, nga përfaqësuesit jugosllavë dhe ata sovjetikë.²⁴ Falë edhe kësaj mbështetjeje, në hapjen e Konferencës së Paqes, ishte i pranishëm një delegacion shqiptar me statusin e vëzhguesit, të cilit më 18 gusht 1946 iu bashkua edhe Kryeministri Enver Hoxha, i cili parashtroi qëndrimin shqiptar në lidhje me Traktatin, por kundërshtoi njëkohësisht edhe pretendimet greke ndaj Shqipërisë së Jugut.

Konferenca e Paqes i diskutoi kërkesat e Shqipërisë në tri komisione të veçanta, në atë politik tokësor, ekonomik dhe ushtarak. Shqipëria nuk u ftua të ishte e pranishme në shumicën e mbledhjeve të këtyre komisioneve, por thirrej sa herë që anëtarët kishin nevojë të dëgjonin sqarimet e Tiranës zyrtare. Italia pranoi të gjitha përcaktimet e Traktatit të Paqes sa i takonte pavarësisë dhe integritetit territorial të Shqipërisë, madje kërkoi që edhe fqinjët tokësorë të bënin të njëjtat deklarata në sigurimin e pavarësisë së vendit të vogël ballkanik. Italia nuk kundërshtoi edhe vendimin e Konferencës për kthimin e ishullit të Sazanit, Shqipërisë.

Debatet më të shumta u zhvilluan në mbledhjet e komisionit ekonomik, i cili shqyrtoi kërkesat e Shqipërisë në lidhje me çështjen e

²² AMPJ, V. 1946, D. 160, fl. 2-9. Memorandum i qeverisë shqiptare për dëmshpërblimet me Italinë.

²³ H. Kaba, “Dëmshpërblimet italiane të Luftës së Dytë Botërore për Shqipërinë (1945-1960)...”, 125.

²⁴ Sonila Boçi, *Minoritetet në Shqipëri midis identitetit dhe integritetit (1939-1949)*, QSA, Instituti i Historisë (Tiranë: Kristalina-KH, 2012), 148-149.

reparacioneve, restitucioneve,²⁵ midis të cilave u diskutua edhe e drejta e Shqipërisë për kthimin e arit monetar. Gjatë diskutimeve, Italia mbrojti qëndrimin e saj se investimet italiane në Shqipëri i tejkalonin dëmet e shkaktuara nga lufta, prandaj ajo nuk duhej të paguante dëmshpërblime të mëtejshme.²⁶ Për Tiranën, jo të gjitha investimet italiane ishin në interes të ekonomisë shqiptare. Sipas saj, një pjesë e fondeve të parashikuara për këto investime ishin përvetësuar nga hierarkët e lartë fashistë me detyrë në Shqipëri, kurse pjesa më e madhe e tyre u kishte shërbyer qëllimeve imperialiste italiane, duke ndikuar negativisht në ekonominë shqiptare. Për qeverinë shqiptare, investimet italiane në infrastrukturën rrugore reflektonin nevojat ushtarake dhe strategjike të Italisë dhe nuk i shërbenin aspak ekonomisë shqiptare.²⁷ Një pjesë e investimeve, madje u kishin shkaktuar dëme të shumta degëve jetike të ekonomisë shqiptare, siç ishte p.sh. bujqësia. Gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore, shumica e investimeve italiane, veçanërisht ato në infrastrukturën rrugore ishin shkatërruar. Për të gjitha këto arsye, qeveria shqiptare këmbëngulte në kërkesat e saj për të përfituar dëmshpërblime nga Italia.²⁸

Aleatët perëndimorë i gjykuan të ekzagjeruara kërkesat e paraqitura nga Shqipëria. Si SHBA-ja ashtu edhe Britania e Madhe, konsekuente në qëndrimin e tyre për të mos e rënduar ekstremisht ekonominë e shkatërruar italiane me një paqe ndëshkuese, mendonin se Shqipëria dhe Etiopia duhej të dëmshpërbleheshin duke përvetësuar/nacionalizuar pasuritë italiane në vend. Aleatët perëndimorë ishin të bindur se pasuritë dhe investimet italiane në Shqipëri ishin të mjaftueshme për të

²⁵ Është fjala për kërkesën e qeverisë shqiptare për të kthyer në Shqipëri rreth 400 sende me vlerë, kryesisht objekte arkeologjike, pjesë e muzeut arkeologjik të Vlorës, të cilat ishin përvetësuar nga ushtarët italianë menjëherë pas hyrjes së tyre në qytet, si dhe një numër objektesh arkeologjike dhe antropologjike të cilat ishin çuar në Itali në prill të vitit 1940 për t'u ekspozuar në "Mostra d'Oltre Mare" të Napolit. Lista e përpiluar me shumë kujdes e profesionalizëm nga arkeologu Hasan Ceka përshinte gjithashtu edhe një koleksion dinarësh argjendi të zbuluar në Durrës më 1941, të cilët i ishin dhuruar me urdhër të këshilltarit të Ministrisë së Arsimit, Mario Morandit, ish-Mëkëmbësit të Përgjithshëm, Francesco Jacomoni-t. Shih: *AMPJ*, V. 1946, D. 163, fl. 2-19. "Relacion mbi damet e shkaktuara në sendet me vlerë arkeologjike, artistike dhe historike si rrjedhojë t'okupacionit italian", përgatitur nga Hasan Ceka, 30 mars 1946.

²⁶ Për më shumë mbi qëndrimin italian për çështjen e dëmshpërblimeve, shih: S. Stallone, *Prove di diplomazia adriatica ...*, 157, 160-163, 169.

²⁷ *AMPJ*, V. 1946, D. 163, fl. 103-110. Relacion i Drejtorisë Rruga-Ura mbi dëmet që i ka shkaktuar Italia fashiste Shqipërisë në rrugë, ura dhe ndërtime portuale, pa datë.

²⁸ *Po aty*.

kompensuar dëmet e shkaktuara nga lufta. Madje, kryetari i Misionit Civil Amerikan në Shqipëri, Joseph Jacobs, shfaqte mendimin se “Shqipëria kishte përfituar nga okupacioni italian më shumë se dëmet që kishte pësuar”.²⁹ Në të vërtetë, shumat e kërkuara nga qeveria shqiptare ishin tepër të larta. Prof. Arben Puto pohon me të drejtë se ato patën efektin e kundërt gjatë diskutimeve, pasi nuk u besuan. Madje, nuk u morën parasysh edhe kur delegacioni shqiptar deklaroi se do të mjaftoheshin me 1/3 e shumave të kërkuara. Kështu, në fillim të tetorit, komisioni i posaçëm i dëmshpërblimeve në varësi të Komisionit të Ekonomisë, votoi propozimin amerikan për t’ia hequr Shqipërisë të drejtën për të kërkuar dëmshpërblime nga Italia.³⁰ Situata ndryshoi pasi komisioni ekonomik pranoi kërkesën e Shqipërisë për t’u pranuar si fuqi-shoqe.³¹

Konferenca e Paqes e Parisit i mbylli punimet në tetor të vitit 1946 pa marrë vendime përfundimtare për një sërë çështjesh. Ajo i ngarkoi detyrë Këshillit të Ministrave të Jashtëm për të diskutuar në detaje çështjet për të cilat nuk ishte marrë ende një vendim. Më 22 dhjetor 1946, përfundoi në Nju Jork mbledhja e Këshillit të Ministrave të Jashtëm, e cila përpiloi draftin përfundimtar të Traktati të Paqes me Italinë. Ishte e qartë se ai ishte produkt i një kompromisi të arritur ndërmjet Aleatëve të Mëdhenj, kompromis ky që nuk kishte qenë i munduar gjatë diskutimeve në Konferencën e Paqes. Sekretari amerikan i Shtetit, Byrnes, vazhdonte të këmbëngulte në propozimin e tij se Shqipërisë nuk duhej t’i njihej e drejta për dëmshpërblime nga Italia, por kjo nuk u pranua nga anëtarët e tjerë. Këshilli nuk kishte pranuar as propozimin sovjetik për t’i akorduar Shqipërisë 25 milionë dollarë amerikanë dëmshpërblim. Përfundimisht, si zgjidhje kompromisi u miratua propozimi francez dhe Shqipërisë iu caktua shuma prej 5 milionë dollarësh në formë dëmshpërblimesh nga Italia. Gjithashtu, asaj iu njoh e drejta e restitucioneve dhe e pronësisë mbi pasuritë e shtetasve italianë në Shqipëri, në masën që përmbushnin dëmet e pësura nga shteti dhe shtetasit shqiptarë, si dhe kthimi i

²⁹ Arben Puto, *Lufta italo-greke: diktatorë e kuislingë* (Tiranë: UMSH Press&Toena, 2011), 284; H. Kaba, “Dëmshpërblimet italiane të Luftës ...”, 125.

³⁰ A. Puto, *Lufta italo-greke ...*, 284.

³¹ Shqipëria u njoh si fuqi-shoqe nga Këshilli i Ministrave të Jashtëm në takimin e New York-ut, më 9 nëntor 1946, kur Konferenca e Paqes i kishte përfunduar punimet më 15 tetor. Shih: Hamit Kaba, “Kosova në kryqëzim gjeopolitik: Shqipëria, Jugosllavia dhe Fuqitë e Mëdha 1945-1948”, *Studime historike*, nr. 1-2 (2021), 230.

kriminelëve të luftës. Diskutime pati edhe për çështjen e nënshkrimit të traktatit nga Shqipëria. SHBA-ja nuk ishte dakord me idenë që qeveria shqiptare të ishte një nga nënshkrueset, por më në fund u pranua formula që parashtrohej në nenin 77 të Traktatit. Sipas këtij neni, “vendet jo nënshkruese të këtij Traktati, të cilat janë në luftë me Italinë, do të mund të aderojnë në këtë Traktat dhe, pas aderimit, do të konsiderohen si fuqi-shoqe për qëllimet e këtij Traktati. Instrumentet e aderimit do të depozitohen pranë qeverisë së Republikës Franceze dhe do të kenë efekt pas depozitimit”.³² Përfaqësuesi sovjetik dhe ata shqiptarë në Nju Jork njoftonin me të drejtë MPJ-në shqiptare se përfundimet për Shqipërinë ishin të kënaqshme.³³ Shqipëria kishte arritur një fitore politike, duke u pranuar si fuqi-shoqe, gjë që hidhte poshtë pretendimet greke se Shqipëria ishte një nga shtetet me të cilat ishte në luftë, por edhe qëndrimin italian sipas të cilit Shqipëria nuk ishte zyrtarisht në luftë kundër Italisë. Me këtë status, Shqipërisë iu hap rruga për të përfituar dëmshpërblime nga Italia.

Seksioni V i Traktatit të Paqes me Italinë rregullonte marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Italisë. Sipas tij, Italia do ta njihnte sovranitetin dhe pavarësinë e shtetit shqiptar (neni 21); Shqipërisë i kalonte ishulli i Sazanit (neni 22); Italia hiqte dorë nga të gjitha pronat që kishte në Shqipëri, si dhe nga çdo pretendim për ndikim apo interesa të veçantë në vend (neni 23); Shqipëria duhej t’u garantonte shtetasve italianë të njëjtat të drejta me shtetasit e tjerë të huaj (neni 24); të gjitha marrëveshjet e nënshkruara ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë, nga prilli i vitit 1939 deri në shtator të vitit 1943, konsideroheshin të anuluar (neni 25). Traktati i Paqes me Italinë u nënshkrua më 10 shkurt 1947 në Paris. Më 9 tetor të vitit 1947, Presidiumi i Kuvendit Popullor të RPSH-së e ratifikoi atë, duke i hapur rrugën qeverisë shqiptare të aderonte në të. Aderimi u bë më 20 tetor të vitit 1947.³⁴

³² *Foreign Relations of the United States* (më tej: *FRUS*), 1946, *Eastern Europe, The Soviet Union*, Volume VI, editors Rogers P. Churchill, William Slany (Washington: United States Government Printing Office, 1969), 36. Traktati i Paqes me Italinë.

³³ *AMPJ*, V. 1946, D. 10, fl. 6-9. Informacion mbi bisedimet e Hysni Kapos dhe Behar Shtyllës me përfaqësuesin sovjetik në Këshillin e Ministrave të Jashtëm, Gusev, 23 dhjetor 1946.

³⁴ H. Kaba, *Shqipëria në rrjedhën e Luftës së Ftohtë...*, 126.

Riatdhesimi i italianëve dhe çështja e njohjes së qeverisë provizore shqiptare nga Italia

Italia e vitit 1945 kishte interes të rivendoste kontakte të menjëhershme me Shqipërinë në mënyrë që të zgjidhte me anë të bisedimeve bilaterale shumë probleme imediate, midis të cilave riatdhesimin e italianëve që ende ndodheshin në Shqipëri. Shqipëria, nga ana tjetër, kishte nevojë për konsolidimin e statusit të saj ndërkombëtar dhe sigurimin e njohjes së administratës së dalë nga lufta. Në njëfarë mënyre, riatdhesimi i italianëve dhe njohja e qeverisë shqiptare nga Italia ishin dy çështje të ndërvarura nga njëra-tjetra.

Në momentin e kapitullimit të Italisë, në Shqipëri gjendeshin rreth 100 000 trupa ushtarake italiane, si dhe civilë të ardhur para Luftës së Dytë Botërore dhe në kuadër të projektit italian të kolonizimit të Shqipërisë gjatë viteve 1940-41. Një pjesë e ushtarëve italianë gjetën mundësinë të largoheshin në vjeshtën e vitit 1943 për në Itali, një pjesë u ekzekutuan apo u internuan nga pushtuesit gjermanë. Pjesa tjetër u shpërnda nëpër shtëpitë e fshatarëve shqiptarë ose iu bashkua formacioneve partizane. Ata madje krijuan edhe një batalion, të quajtur Antonio Gramsci, pjesë e Brigadës I S.³⁵ Për numrin e italianëve të mbetur në Shqipëri, burimet kanë disa mospërputhje. Sipas Ministrisë së Jashtme të RPSH-së, në momentin e largimit të trupave gjermane nga Shqipëria ndodheshin 27 000 italianë, prej të cilëve 20 000 ishin ushtarakë dhe rreth 7 000 ishin civilë.³⁶ Burimet britanike japin një shifër tjetër, e cila u referohet të dhënave të mbledhura nga Misioni britanik në mënyrë jozyrtare, por, sipas tyre, nga burime të besueshme. Burimet flisin për 24 090 italianë në Shqipëri (18 630 ushtarakë dhe 5 460 civilë).³⁷ Duke u nisur nga mënyra shumë e kujdesshme me të cilën punoi qeveria shqiptare për të mbledhur të dhëna mbi italianët e mbetur në

³⁵ Për ushtarët italianë në formacionet ushtarake të LNÇ-së, shih: Edon Qesari, “Një *légion étrangère* mes shqiptarësh: historia e batalionit “Antonio Gramsci” (1943-1944)”, në *Studime historike*, nr. 3-4 (2021), 143-168.

³⁶ *AMPJ*, V. 1948, D. 146, fl. 38. Radiogram i MPJ-së për legatat shqiptare në Moskë, Beograd, Paris, Sofje, nr. Z. 41/22 rez., 13 shkurt 1948.

³⁷ *The National Archives*, London (më tej: *TNA*), Special Operation Executive, Historical Section (HS) 5/54. Raporte politike periodike të Misionit Ushtarak Britanik për Shqipërinë, nr. 4, 1 qershor 1945.

Shqipëri, si dhe nga fakti që këtë shifër e ka pranuar edhe qeveria italiane, mendoj se shifra 27 000 është më e sakta.

Në territorin shqiptar u krijuan dy shoqata që synonin të mblidhnin dhe të organizonin italianët që gjendeshin në Shqipëri: Rrethi Demokratik Popullor Italian “Giuseppe Garibaldi”, i quajtur ndryshe *Rrethi Garibaldi* (Circolo Garibaldi) dhe Komanda e Trupave Italiane në Shqipëri. *Rrethi Garibaldi* u krijua menjëherë pas çlirimit të Tiranës. Më 23 nëntor 1944, një grup antifashistësh italianë, banues në Tiranë, Enrico Danek, Gioacchino Magnoni, Ugo Merola, Arnolfo Nizzola etj., krijuan Grupin Demokratik Popullor Italian, paraardhësin e *Rrethit Garibaldi*.³⁸ Në fillim të vitit 1945, shoqatës iu bashkuan dhe anëtarët e batalionit “Antonio Gramsci”, duke e riorganizuar dhe shtrirë atë në të gjithë vendin. Pas kësaj, në krye të *Rrethit Garibaldi* u zgjodh Arnolfo Nizzola. Shoqata kujdesej për t’iu ardhur në ndihmë italianëve që gjendeshin në Shqipëri. Ata hartonin statistika për vendndodhjen e tyre, evidentonin nevojat e tyre, siguronin ndihma materiale për ta, lehtësonin komunikimin e tyre me të afërmit në Itali dhe ndërmjetësonin për probleme të ndryshme me qeverinë shqiptare. *Rrethi Garibaldi*, gjithashtu propagandonte mbi “përparësitë e demokracive popullore”.³⁹ Duke qenë një shoqatë me tendenca majtiste dhe antifashiste, *Rrethi Garibaldi* pati mbështetjen e qeverisë shqiptare. Madje, në strukturat e larta drejtuese të Rrethit u përfshinë, në bazë të Statutit tre shqiptarë: Theodor Heba, Sami Baholli dhe Stavri Leka.⁴⁰

Rrethi Garibaldi nuk ishte njohur nga Roma si ndërmjetës pranë qeverisë shqiptare për të mbrojtur interesat e shtetasve italianë në Shqipëri. Këtë të drejtë qeveria italiane ia kishte ngarkuar Komandës së Trupave Italiane, të kryesuar nga gjenerali Gino Piccini.⁴¹ Më 8 shtator 1943, gjenerali kishte vendosur të luftonte kundër gjermanëve së bashku me divizionin e tij dhe, kur trupat pushtuese u larguan nga Shqipëria, ai,

³⁸ AQSH, F. 445/Circolo Garibaldi, V. 1945, D. 52, fl. 35. Historiku i krijimit të *Rrethit Garibaldi*.

³⁹ *Po aty*, fl. 7. Neni 6 i Statutit të *Rrethit Garibaldi*.

⁴⁰ *Po aty*, fl. 36. Njoftim i *Rrethit Garibaldi* për Ministrinë e Punëve të Brendshme, 29 dhjetor 1945.

⁴¹ S. Stallone, *Prove di diplomazia adriatica ...*, 27; Enriketa Papa Pandelejmoni, “Il rimpatrio degli italiani e lo stallo nelle relazioni Albania-Italia (1945-1957)”, in *Una pace necessaria: I rapporti italiano-albanesi nella prima fase della Guerra fredda*, a cura di Paolo Rago (Roma: Laterza, 2017), 131.

me mbështetjen dhe shtytjen e britanikëve, krijoi Komandën e Trupave Italiane me qëllim që të bashkonte të gjithë ushtarakët italianë në një komandë të përbashkët. Ashtu si *Rrethi Garibaldi*, edhe Komanda e gjeneral Piccini-t synonte t'i ndihmonte materialisht italianët e mbetur në Shqipëri. Për më tepër, Roma zyrtare i ngarkoi kësaj shoqate përgjegjësinë për të ndërmjetësuar ndërmjet dy qeverive në lidhje me riatdhesimin e italianëve. Komanda e Trupave Italiane në Shqipëri mbante gjithashtu lidhje të rregullta edhe me misionet britanike dhe amerikane, si dhe me përfaqësuesit e UNRRA-s në vend. Ndërsa me *Rrethin Garibaldi* marrëdhëniet ishin të tensionuara, pasi ata e konsideronin gjeneralin një njeri të Badoglio-s që, me urdhër të tij, kishte luftuar kundër gjermanëve për të shpëtuar pozitën e tij personale në ushtrinë italiane.⁴²

Çështja e riatdhesimit të italianëve filloi të merrte rrugë në pranverë të vitit 1945. Më 10 mars 1945 në Shqipëri mbërriti për një vizitë nënsekretari italian i Shtetit për Luftën, Mario Palermo. Ai ishte një nga përfaqësuesit e PKI-së në qeverinë italiane të koalicionit të drejtuar nga Ivanoe Bonomi. Përkatësia politike e ministrit italian nuk ishte pa rëndësi. PKSHP ishte e interesuar të vendoste marrëdhënie me PKI-në, ndoshta në një tentativë të dëshpëruar të Hoxhës për t'u shkëputur nga tutela jugosllave. Kadri Hoxha, shefi i misionit ushtarak shqiptar në Bari, kujton se në një takim mes tij, Enver Hoxhës dhe Nako Spirut në shkurt të 1945-s, ky i fundit i kishte kërkuar të vendoste kontakte me PKI-në dhe sekretarin e saj Palmiro Togliati dhe t'i shprehte atij dëshirën e PKSHP-së për të vendosur marrëdhënie në nivel partiak. Kadri Hoxha ia kishte transmetuar këtë dëshirë të drejtuesve të lartë të PKSHP-së, Togliati-t me anë të bashkëshortes së tij.⁴³ Përgjigjja e kreut të PKI-së, i cili mbante postin e ministrit të Drejtësisë në qeverinë e koalicionit kishte qenë se kontaktet duhej të mbaheshin me Mario Palermo-n. Takimi mes Hoxhës dhe Palermo-s u zhvillua në shtëpinë e nënsekretarit të shtetit italian. K. Hoxha kujton se Palermo e kishte pritur me kënaqësi propozimin e PKSHP-së “që dy partitë tona të komunikojnë dhe të shkëmbejnë eksperiencë midis tyre”. Palermo theksoi se qëllimi i vizitës së tij të

⁴² AQSH, F. 445/Circolo Garibaldi, V. 1945, D. 53/1, fl. 8. Relacion i *Rrethit Garibaldi* në përgjigje të kërkesës së gjeneral Piccini-t për të bashkëpunuar në lidhje me statistikat për numrin dhe shtrirjen e italianëve në Shqipëri, gusht 1945.

⁴³ *Po aty*, F. 789/Kadri Hoxha, V. pa vit, D. 6, fl. 35. Kujtimet e Kadri Hoxhës të shkruara më 1998.

ardhshme në Shqipëri nuk ishte ai partiak, por shtetëror me synimin për “t’u interesuar pranë qeverisë shqiptare për riatdhesimin e ushtarëve italianë” që ndodhen akoma në Shqipëri. Politikani komunist nuk harroi të përmendte se përfundimi i suksesshëm i vizitës së tij në Shqipëri do ta ndihmonte PKI-në, pasi “do të shtonte akoma më shumë solidaritetin e popullit italian ndaj Partisë Komuniste Italiane”.⁴⁴

Vizita e Palermo-s në Shqipëri kishte një rëndësi të veçantë për Romën, veçanërisht pas ekzekutimit të dy inxhinierëve italianë të shoqërisë së naftës AIPA,⁴⁵ gjë që e bëri real shqetësimin për sigurinë e jetës së bashkëkombësve të tyre në Shqipëri. Më 6 mars 1945 në Ministrinë e Luftës u zhvillua një takim ndërministror, në të cilin u përcaktua qëndrimi i qeverisë italiane për vizitën e pritshme të nënsekretarit të Luftës në Shqipëri. Palermo duhej të këmbëngulte për riatdhesimin e të gjithë italianëve ushtarakë dhe civilë, por ai duhej të shmangte diskutimet për çështje të tjera të nxehta si ajo e pasurisë së italianëve në Shqipëri apo të njohjes së qeverisë shqiptare. Sa i takon kësaj të fundit, Palermo duhej ta bënte të qartë pozitën ndërkombëtare të Italisë, e cila “nuk mund të merrte iniciativa për një akt, të cilin asnjë nga Fuqitë e Mëdha nuk e kishin ndërmarrë deri tani”.⁴⁶ Pavarësisht kësaj qeveria italiane shprehej e gatshme të hynte në marrëdhënie në nivel ekspertësh për të diskutuar çështje të ndryshme. Hapja në Tiranë e një misioni ushtarak, në të cilin do të përfshiheshin edhe civilë, do të garantonte një lidhje të vazhdueshme midis dy vendeve.⁴⁷

Pas një qëndrimi katërditor, në të cilin Palermo vizitoi të gjitha rajonet e Shqipërisë ku ishin grumbulluar italianët dhe u njoh nga afër me jetën e vështirë të tyre në “kufi të mbijetesës”,⁴⁸ më 14 mars u nënshkrua një marrëveshje ndërmjet Palermo-s dhe Enver Hoxhës. Marrëveshja përmbante 12 nene, të cilat rregullonin në vija të përgjithshme çështjen e riatdhesimit të italianëve. Qeveria shqiptare merrte përsipër të riatdhesonte të gjithë italianët që nuk ishin të nevojshëm për rimëkëmbjen e ekonomisë shqiptare. Riatdhesimi do të fillonte më 15

⁴⁴ *Po aty*, fl. 36. Kujtimet e Kadri Hoxhës të shkruara më 1998.

⁴⁵ S. Stallone, *Prove di diplomazia adriatica ...*, 42.

⁴⁶ *DDI*, X Serie, V. II, dok. nr. 80 (102-103). Procesverbal i takimit ndërministror, Romë, 6 mars 1945.

⁴⁷ S. Stallone, *Prove di diplomazia adriatica ...*, 45.

⁴⁸ E. Papa Pandelejmoni, “Il rimpatrio degli italiani e lo stallo nelle relazioni Albania-Italia (1945-1957) ...”, 132. Autorja u referohet kujtimeve të Mario Palermo-s.

prill 1945 dhe do të ndiqte rendin e përcaktuar në protokollin e bisedimeve, sipas të cilit, në fillim do të riatdhesoheshin ushtarakët italianë të inkuadruar në batalionin “Antonio Gramsci” dhe në njësi të tjera të UNÇ-së si dhe të sëmuret. Në një kohë të dytë 10 000 civilë dhe, më pas, të gjithë civilët e mbetur.⁴⁹ Qeveria italiane merrte përsipër të siguronte mjetet e nevojshme të transportit, ndërsa ajo shqiptare do të lejonte të gjithë personat që riatdhesoheshin të merrnin me vete sendet e tyre me vlerë, paratë e depozituara në Bankën e Shqipërisë dhe objektet personale.

Qeveria shqiptare duhej të kujdesej për lidhjen e kontratave të rregullta me italianët e mbetur në Shqipëri si specialistë dhe teknikë. Ata duhej të lejoheshin të komunikonin me familjet e tyre dhe të bënin vizita të herëpashershme në atdhe. Italianët që do të mbeteshin në Shqipëri, do të ishin të detyruar të zbatonin, sipas protokollit, ligjet shqiptare. Ata italianë që ishin të nevojshëm për ekonominë shqiptare, por që kërkonin të riatdhesoheshin, qeveria italiane merrte përsipër t’i zëvendësonte me specialistë të tjerë. Listat e italianëve që do të riatdhesoheshin, do t’i bëheshin të ditura qeverisë shqiptare nga gjeneral Piccini. Për të shqyrtuar problematikat që mund të lindnin gjatë procesit, do të dërgohej në Tiranë një mision zyrtar italian. Qeveria shqiptare ftohej të bënte të njëjtën gjë.⁵⁰

Marrëveshja Hoxha-Palermo, ishte një sukses për të dyja palët. Për Romën ishte një fitore politike, por dhe humanitare, pasi përveçse vendosi kontakte me Tiranën zyrtare, do të sillte në shtëpi mijëra bashkëkombës. Për qeverinë provizore të Hoxhës kjo ishte marrëveshja e parë ndërkombëtare e nënshkruar nga autoritetet shqiptare, ende të panjohura nga Aleatët e Mëdhenj. Marrëveshja dhe, mbi të gjitha, obligimi i palës italiane për të dërguar një mision zyrtar në Shqipëri, i shqetësoi aleatët perëndimorë. Qeveria britanike i kërkoi Romës shpjegime nëse marrëveshja, e arritur ndërmjet avokat Palermo-s dhe Enver Hoxhës, nënkuptonte njohjen e qeverisë shqiptare nga Italia. Përgjigjja e kryeministrit italian ishte negative sa i takon njohjes së qeverisë shqiptare. Ai e siguronte qeverinë britanike se marrëveshja

⁴⁹ AMPJ, V. 1945, D. 33, fl. 10-11. Protokoll i bisedimeve të zhvilluara në datat 10, 11, 12, 13 dhe 14 ndërmjet kryetarit të qeverisë shqiptare, Enver Hoxha dhe nënsekretarit të Shtetit për Luftën, avokat Mario Palermo.

⁵⁰ *Po aty.*

synonte të rregullonte disa probleme teknike që lidheshin me interesat e shtetasve italianë në Shqipëri.⁵¹

Më 29 korrik 1945 mbërriti në Shqipëri Misioni italian i kryesuar nga konsulli Ugo Turcato. Hezitimi i aleatëve perëndimorë për ta pranuar marrëveshjen Hoxha-Palermo krijoi vështirësi për detyrën e re të Turcato-s. Misioni i tij nuk ishte i pajisur në mbërritje me *agrementin* zyrtar, çka krijoi probleme në marrëdhëniet e tij me autoritetet shqiptare. Për gati një muaj, Kryeministri Hoxha refuzoi kërkesat e përsëritura të Turcato-s për takim.

Nga mesi i gushtit, ministri i Jashtëm De Gasperi njoftoi zyrtarisht qeverinë shqiptare për caktimin e Ugo Turcato-s si kryetar të Misionit italian në Shqipëri. Turcato u takua, më në fund, me Hoxhën, më 26 gusht 1945. Takimi reflektoi edhe njëherë pozitën e vështirë ndërkombëtare të qeverisë shqiptare dhe nevojën e ngutshme të saj për të zgjeruar marrëdhëniet ndërkombëtare. Turcato i raportonte eprorëve të vet, sjelljen dashamirëse të Hoxhës ndaj tij. Kryeministri shqiptar nuk kishte munguar për të shprehur admirimin e tij personal kundrejt kreut të qeverisë italiane Fari, si një prej udhëheqësve të rezistencës italiane kundër Boshtit. Hoxha e kishte ftuar diplomatit italian për të ecur drejt stabilizimit të marrëdhënieve shtetërore, pasi, sipas tij, të dyja vendet “duhet të vështrojmë nga e ardhmja dhe të punojmë në mirëkuptim të përbashkët për të shëruar plagët e të kapërcejmë pengesat për një miqësi midis dy popujve”.⁵²

Ndërsa Hoxha vinte theksin në stabilizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve, Turcato ishte i përqendruar në mbarëvajtjen e misionit të tij, pra në riatdhesimin e italianëve të mbetur në Shqipëri. Hoxha pranoi kërkesën e diplomatit italian për të lehtësuar transportin e italianëve që ndodheshin në Shqipëri drejt porteve të Vlorës dhe Durrësit, por ai nuk ra dakord për transportin e sendeve me vlerë të tyre, si dhe për riatdhesimin e ‘specialistëve’.⁵³ Pavarësisht përzemërsisë së treguar nga Hoxha gjatë takimit, shtypi i kohës nuk shkroi as edhe një njoftim të shkurtër. Për të dëshmuar se nga cila anë qëndronte besnikëria e autoriteteve qeverisëse shqiptare, takimi i kreut të misionit ushtarak sovjetik, kolonelit Sokolov

⁵¹ Për më shumë mbi reagimet britanike në lidhje me marrëveshjen Hoxha-Palermo, shih: S. Stallone, *Prove di diplomazia adriatica ...*, 49-57.

⁵² *DDI*, X Serie, vol. II, dok. nr. 466 (629). 466, f. 629. Shefi i misionit në Shqipëri për ministrin e Jashtëm, De Gasperi, Tiranë, 26 gusht 1945.

⁵³ *Po aty*.

me Enver Hoxhën, i zhvilluar menjëherë pas atij me diplomatin italian, u pasqyrua gjerësisht në shtypin e kohës. Në mënyrë reciproke, qeveria shqiptare caktoi avokat Foni Qirkon si kryetar i Misionit shqiptar në Romë, por ai nuk arriti kurrë në kryeqytetin italian. Për aleatët perëndimorë, misioni ushtarak shqiptar pranë Shtabit Aleat të Mesdheut, i kryesuar nga Kadri Hoxha ishte i mjaftueshëm për të mbrojtur interesat e shtetasve shqiptarë në Itali.⁵⁴

Procesi i riadhesimit të italianëve u lehtësua nga Ndërlidhja Ushtarake dhe Misioni i UNRRA-s. Në pranverë të vitit 1945, ishte Ndërlidhja Ushtarake për Shqipërinë, e cila mori përsipër furnizimin me ushqime dhe transportin e italianëve për në Itali. Gjatë muajve maj-korrik 1945, falë kësaj ndihme, u riadhesuan 16 000-17 000 italianë, kryesisht partizanë të batalionit “Antonio Gramsci” dhe të sëmurët.⁵⁵ Pas mbërritjes së Turcato-s në Shqipëri, në një takim midis tij, shefit të misionit ushtarak britanik, Hodgson dhe përfaqësuesve të UNRRA-s u përcaktuan përgjegjësitë e secilës palë në procesin e riadhesimit të italianëve. UNRRA do të merrte përsipër ndihmat materiale, furnizimet dhe transportin e shtetasve italianë, ndërsa misioni i Turcato-s do të paraqiste listat e tyre dhe do të siguronte lejen e riadhesimit nga qeveria shqiptare.⁵⁶

Ndërsa çështja e riadhesimit të italianëve dukej se ishte në rrugën e duhur, çështja e rivendosjes së marrëdhënieve midis dy vendeve po përparonte me shumë vështirësi. Aleatët perëndimorë vijonin të nxisnin stabilizimin e marrëdhënieve mes Italisë dhe Greqisë, duke e

⁵⁴ Miratimi i aleatëve perëndimorë për dërgimin e misionit zyrtar shqiptar në Itali u dha vetëm në nëntor të 1945-s. Gjatë kohës që po bëheshin përgatitjet për ta dërguar avokatin dhe personelin tjetër diplomatik shqiptar në Itali, situata politike në vend ndryshoi me shpejtësi. Qeveria shqiptare pas zgjedhjeve të 2 dhjetorit, nuk ishte më e interesuar për të stabilizuar marrëdhëniet me Italinë, gjë që u konkretizua edhe me largimin nga Shqipëria të Misionit italian. Për më tepër shih: *AMPJ*, V. 1945, D. 30, fl. 7-9. Mbi caktimin e avokat Foni Qirkos si kreu i Misionit shqiptar në Itali.

⁵⁵ “Riadhesimi i robërve të luftës dhe i personave të shpërngulur në vitet 1945-1947”, në Hamit Kaba, *Shqipëria në rrjedhën e Luftës së Ftohtë (studime dhe dokumente)*..., 86; Enriketa Papa Pandelejmoni, “Il rimpatrio degli italiani e lo stallo nelle relazioni Albania-Italia (1945-1957)”, në *Una pace necessaria: I rapporti italiano-albanesi nella prima fase della Guerra Fredda*, a cura di Paolo Rago (Roma: Laterza, 2017), 134.

⁵⁶ H. Kaba, “Riadhesimi i robërve të luftës dhe i personave të shpërngulur në vitet 1945-1947...”, 89.

paralajmëruar Romën për mungesën e gatishmërisë së Shqipërisë për stabilizimin e marrëdhënieve.⁵⁷ Gjithsesi nga fillimi i dhjetorit të 1945-s, demarshet e qeverisë italiane pranë aleatëve patën sukses, pasi ata e hapën dritën jeshile për stabilizimin e marrëdhënieve mes Italisë dhe Shqipërisë.⁵⁸ Por, ashtu siç kishin parashikuar aleatët perëndimorë, situata në Shqipëri kishte ndryshuar në mënyrë drastike edhe për sa u përkiste marrëdhënieve me Italinë. Pas zgjedhjeve të 2 dhjetorit 1945, drejtuesit e lartë të PKSH-së gjykuan se kishte ardhur koha për ta bërë publike prirjen e Shqipërisë ndaj Bashkimit Sovjetik. Politika e mbajtjes së një lloj ekuilibri në marrëdhëniet ndërkombëtare, përfshirë edhe stabilizimin e marrëdhënieve me Italinë u konsiderua e gabuar.⁵⁹ Nga fundi i dhjetorit të 1945-s, pjesës më të madhe të anëtarëve të Misionit italian në Shqipëri iu kërkua nga Drejtoria e Mbrojtjes së Popullit (paraardhësja e Sigurimit të Shtetit) të largoheshin nga vendi.⁶⁰ Me gjithë demarshet pranë autoriteteve shqiptare, më 14 janar 1946 iu kërkua të largohet nga Shqipëria edhe Turcato-s, pasi, sipas autoriteteve shqiptare, misioni i tij e kishte përmbushur detyrën dhe nuk ishte më e nevojshme qëndrimi i tyre në vend.⁶¹

Shtypi zyrtar në Shqipëri filloi paralelisht një fushatë antiitaliane. Kreu i Misionit italian dhe anëtarët e tij u akuzuan publikisht si të përfshirë në kontrabandë floriri⁶² dhe në sabotime të ekonomisë

⁵⁷ *Documenti (I) Diplomatici Italiani* (më tej: DDI), Decima Serie: 1943-1948, vol. III (10 dicembre 1945-12 luglio 1946), a cura di Pietro Pastorelli (Roma: Istituto Poligrafico e Zecca dello Stato, 1993), dok. nr. 3 (5). I Ngarkuari me Punë në Londër, Migone, për Presidentin e Këshillit të Ministrave e ministrin e Jashtëm, De Gasperi, 11 dhjetor 1945.

⁵⁸ *Po aty*, dok. nr. 6 (8-9). Shefi i misionit në Shqipëri, Turcato, për shefin e zyrës Tetë të Drejtorisë së Përgjithshme të Çështjeve Politike, Castellani, 11 dhjetor 1945.

⁵⁹ *AQSH*, F. 14/AP-OU, V. 1946, D. 2. Plenumi V i KQ të PKSH-së.

⁶⁰ *AMPJ*, V. 1945, D. 31, fl. 1. Notë verbale e Misionit italian në Tiranë për MPJ-në e Shqipërisë, 27 dhjetor 1945 (mbërritur më 28).

⁶¹ *DDI*, X Serie, vol. III, dok. nr. 100 (142-143). Presidenti i i Këshillit të Ministrave dhe ministri i Jashtëm, De Gasperi, për ambasadorin në Moskë, Quaroni-n, 18 janar 1946.

⁶² Gjatë largimit të anëtarëve të misionit nga Shqipëria, ata, pavarësisht imunitetit diplomatik, iu nënshtruan kontrolleve nga ana e forcave ushtarake shqiptare. Në bagazhet e tyre u gjetën sasi monedhash floriri, të cilat u përkisnin shtetasve italianë të riatdhesuar, të cilëve autoritetet shqiptare nuk i kishin lejuar të merrnin me vete paratë dhe sendet me vlerë. Për më tepër mbi këtë çështje, shih: S. Stallone, *Prove di diplomazia adriatica ...*, 131.

shqiptare.⁶³ Misioni akuzohej gjithashtu se kishte punuar kundër interesave të Shqipërisë dhe si “argument” për këtë përdorëshin marrëdhëniet e ngushta “të karakterit politik dhe financiar” të tij me misionet angloamerikane dhe franceze në Tiranë, si dhe me Misionin e UNRRA-s. Largimi i Misionit italian nga Shqipëria shkatërroi urën për stabilizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve. Një periudhë e tensionuar filloi në marrëdhëniet midis tyre, e cila u përforcua edhe nga Lufta e Ftohtë në marrëdhëniet ndërkombëtare. Në kundërpërgjigje të sjelljes së Tiranës zyrtare, edhe autoritetet italiane rezervuan të njëjtin trajtim ndaj misionit ushtarak shqiptar të vendosur pranë Shtabit Aleat të Mesdheut.⁶⁴

Largimi i Misionit italian nga Shqipëria krijoi boshllëk në mbrojtjen e interesave të qytetarëve italianë, të cilët gjendeshin në Shqipëri. Gjatë vitit 1946, UNRRA mori përsipër të lehtësonte riatdhesimin e tyre. Në muajin shkurt të vitit 1946 u riatdhesuan 253 italianë dhe mbeteshin për t’u riatdhesuar gati edhe 1 500 të tjerë. Me vendimin e UNRRA-s të marsit të 1946-s për të transportuar me anijet e saj të gjithë shtetasit italianë, pavarësisht kohës kur kishin ardhur në Shqipëri, u krijua edhe mundësia për t’u riatdhesuar të gjithë italianët.⁶⁵ Deri në gjysmën e parë të vitit 1946 ishin riatdhesuar të gjithë shtetasit italianë, përveç 961 specialistëve dhe teknikëve, të cilët qeveria shqiptare i konsideronte të nevojshëm për rimëkëmbjen e ekonomisë shqiptare.⁶⁶ Më pas, qeveria italiane u përpoq t’ua besonte mbrojtjen e interesave italiane në Shqipëri

⁶³ Një relacon i Ministrisë së Jashtme, e akuzonte misionin se kishte pasur marrëdhënie të ngushta me shoqëritë italiane të ndërtimeve dhe të transporteve. “Nuk dimë me saktësi, - shkruhej në relacon, - se ç’ influencë e ç’ drejtim u jepte misioni këtyre shoqërive, por fakti është se në disa kantiere italiane pati edhe sabotime”. Shih: *AMPJ*, V. 1945, D. 33, fl. 6. Informacion mbi aktivitetin e Misionit Civil Italian në Shqipëri, nuk dihet kush e ka hartuar informacionin, pa datë.

⁶⁴ Kadri Hoxha kujton se autoritetet doganore italiane kishin kërkuar të kontrollonin bagazhet diplomatike të përfaqësishë shqiptare në Itali. Për disa orë, anëtarët e Misionit shqiptar kishin refuzuar kontrollin e bagazheve, madje duke i kërcënuar autoritetet italiane se do të refuzonin edhe me armë këtë shkelje të statusit të tyre diplomatik. Përpara kërcënimit të një incidenti të rëndë diplomatik autoritetet italiane ishin tërhequr. Për më shumë, shih: *AQSH*, F. 789/Kadri Hoxha, V. pa vit, D. 6, fl. 42. Kujtimet e Kadri Hoxhës të shkruara më 1998.

⁶⁵ Hamit Kaba, *UNRRA në Shqipëri (1944-1947)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë (Tiranë: Shkenca, 2000), 258-266.

⁶⁶ E. Papa Pandelejmoni, “Il rimpatrio degli italiani e lo stallo nelle relazioni Albania-Italia (1945-1957) ...”, 131.

qeverisë franceze, e më pas asaj jugosllave, por ndeshi me refuzimin e vazhdueshëm të Tiranës.⁶⁷

Në vitet 1947-1949, një sërë problematikash kushtëzuan marrëdhëniet shqiptaro-italiane. Për qeverinë italiane, thembra e Akilit ishte çështja e riatdhesimit të italianëve, e cila shkaktonte një ndjeshmëri të lartë në opinionin publik duke u shndërruar në një shqetësim të vazhdueshëm për Romën. Tirana zyrtare nuk iu përgjigj pozitivisht as kërkesës italiane për zëvendësimin e specialistëve dhe të teknikëve, as dhe shtysës së saj për të hartuar dhe nënshkruar kontrata pune me specialistët italianë të mbetur në Shqipëri.⁶⁸

Rivendosja e marrëdhënieve diplomatike mes Italisë dhe Shqipërisë

Ratifikimi dhe hyrja në fuqi e Traktatit të Paqes me Italinë nuk u shoqërua me stabilizimin e marrëdhënieve dypalëshe. Për gati dy vjet kontaktet midis Italisë edhe Shqipërisë munguan pothuajse tërësisht. Tirana akuzonte Italinë për mungesë vullneti në vendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Sipas saj, një sërë veprimesh të Romës zyrtare si: “qëndrimi i qeverisë italiane kundrejt misionit tonë në Bari, qëndrimi armiqësor i delegacionit qeveritar italian në Konferencën e Paqes në Paris, nxitja e italianëve në Shqipëri për të bërë sabotime me qëllim që të dëmtohesh pushteti popullor, fushata armiqësore e shtypit italian mbi gjoja persekutimin e italianëve të mbetur në Shqipëri dhe mbajtja nën vërejtje e përfaqësuesit të qeverisë tonë pranë komisionit naval ... nga ana e policisë italiane, hedhja poshtë e kërkesave tona legjitime për zbatimin e detyrimeve të rrjedhura nga Traktati i Paqes me pretendimin e mungesës së marrëdhënieve diplomatike tregojnë se Italia nuk ka dëshirë të normalizojë marrëdhëniet me Shqipërinë, por ka

⁶⁷ AMPJ, V. 1948, D. 145, fl. 1-4. Korrespondencë ndërmjet legatës franceze në Tiranë, MPJ-së shqiptare dhe asaj të Jugosllavisë mbi çështjen e mbrojtjes së interesave italianë në Shqipëri dhe atyre shqiptarë në Itali, 31 janar - 12 shkurt 1948; shih gjithashtu: S. Stallone, *Prove di diplomazia adriatica ...*, 222.

⁶⁸ Qeveria shqiptare kishte marrë përsipër, në marrëveshjen e marsit 1945, lidhjen e kontratave të punës me të gjithë specialistët italianë që ndodheshin në Shqipëri, por deri më 1948 ishin lidhur shumë pak, për të mos thënë asnjë. Shih: AMPJ, V. 1948, D. 146, fl. 1-3.

vazhduar politikën e saj imperialiste dhe hakmarrëse”.⁶⁹ Refuzimi nga ana e qeverisë italiane për të kthyer “kriminelët e luftës” ishte një nga çështjet më të mprehta për qeverinë shqiptare, veçanërisht pasi qeveritë e Britanisë së Madhe dhe SHBA-së filluan të interesohen për angazhimin e tyre në operacionet “Rollback”.

Italia e shqetësuar për fatin e shtetasve të saj që ende gjendeshin në Shqipëri kërkoi ndërmjetësimin e qeverisë jugosllave. Në një takim të ambasadorit italian në Beograd, Enrico Martino me ministrin e Jashtëm jugosllav, Vladimir Velebi-t, ai arriti të siguronte mbështetjen jugosllave për të ndërmjetësuar pranë qeverisë shqiptare për çështjen e riatdhesimit të italianëve.⁷⁰ Pesë ditë më vonë, Ministria e Jashtëm u kërkoi ministrive të Financave, asaj Botore, të Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Kombëtare, në institucionet vartëse të të cilave ishin të punësuar specialistë dhe teknikë italianë, të përgatishnin listat e italianëve që dëshironin të riatdhesoheshin.⁷¹ Me ndihmën jugosllave për transportin e tyre, gjatë muajve shkurt-prill u riatdhesuan 297 italianë.⁷²

Në prag të zgjedhjeve parlamentare të vitit 1948 në Itali akuza të shumta u artikuluan nga qeveria italiane kundrejt Tiranës zyrtare. Fushata e zgjedhjeve në Itali u shndërrua në një miniarenë të Luftës së Ftohtë, në të cilën SHBA-ja dhe BRSS-ja nuk munguan të mbështesnin forcat reciproke të së djathtës dhe të së majtës.⁷³ Kjo përplasje nuk mund të linte jashtë edhe Shqipërinë. Kreu demokristian Alcide de Gasperi akuzoi qeverinë e E. Hoxhës se tregojë shpërfillëse ndaj dispozitave të Traktatit të Paqes sa i takonte çështjes së riatdhesimit të italianëve. Ministri i Jashtëm, Sforza gjatë një interviste për gazetën “L’Osservatore Romano” fajësonte qeverinë komuniste për situatën ekonomike “në kufij të ekzistencës” me të cilën përballëshin shtetasit italianë në Shqipëri. Ai

⁶⁹ *Po aty*, V. 1946, D. 163, fl. 233. Relacion, me gjasë, i Halim Budos për Ministrinë e Punëve të Jashtëm, pa datë.

⁷⁰ *DDI*, X Serie, vol. VII, dok. nr. 70 (94-95). Ministri Fuqiptotë Martino për ministrin e Jashtëm, Sforza, 3 janar 1948.

⁷¹ *AMPJ*, V. 1948, D. 146, fl. 1-3. Shkresa të MPJ-së për Ministrinë e Financave, të Industrisë, Botore, Bujqësisë, Mbrojtjes Kombëtare, 8 janar 1948.

⁷² E. Papa Pandelejmoni, “Il rimpatrio degli italiani e lo stallo nelle relazioni Albania-Italia (1945-1957) ...”, 142.

⁷³ Për më shumë mbi fushatën e zgjedhjeve të vitit 1948 në Itali, shih: Norman N. Naimark, *Stalin and the fate of Europe, the post-war struggle for sovereignty* (Cambridge, Massachusetts: The Belknap Press of Harvard University Press, 2019), 131-156; G. Mammarella, *L’Italia contemporanea ...*, 129-135.

nuk mungoi të përmendte edhe burgimet dhe dënimet e dhjetëra specialistëve italianë nga gjyqet e manipuluar shqiptare.⁷⁴

Qeveria shqiptare, me nxitjen e asaj jugosllave, u përpoq ta përdorte çështjen e riatdhesimit të italianëve në shërbim të fushatës së PKI-së. Në mars të vitit 1948, ministri shqiptar në Beograd, Ramadan Çitaku pas një takimi me Velebit-in, përcolli mendimin e qeverisë jugosllave për të ndërmarrë një valë të re riatdhesimesh, duke vënë në dukje që “të dërgohen n’Itali demokrat[ë] të mirë [kupto: komunistë] që të shërbejnë në fushatën e zgjedhjeve ... Njerëz të dyshimtë të mos dërgohen”.⁷⁵ Në prag të zgjedhjeve qeveria shqiptare riatdhesoi 30 italianë të përzgjedhur për të ndihmuar fitoren e Frontit të majtë në zgjedhjet parlamentare italiane.⁷⁶ Shtypi komunist në Itali i përdori me kujdes të riatdhesuarit rishtas për të bërë propagandë në favor të modelit sovjetik të qeverisjes, që ata kishin përjetuar në Shqipëri.⁷⁷

Riatdhesimi i italianëve në muajt e parë të vitit 1948 u interpretua nga Italia si një gjest i vullnetit të mirë nga ana e Tiranës, çka e nixti Farnezinën të rifillonte përpjekjet për rivendosjen e marrëdhënieve me Shqipërinë. Pas ndërhyrjes së suksesshme të jugosllavëve në çështjen e riatdhesimit të italianëve, Roma mendoi të përdorte të njëjtin kanal diplomatik edhe për të ndërmjetësuar për vendosjen e marrëdhënieve me Shqipërinë. Më 10 prill 1948, Martini i kërkoi Velebit-it të ndërhynte sërish pranë qeverisë shqiptare, por këtë herë përgjigjja e diplomatit jugosllav ishte negative. Ai u shpreh se qeveria jugosllave nuk kishte ndikimin që mendohej mbi atë shqiptare dhe e ftoi diplomatit italian të zhvillonte një takim me ministrin shqiptar në Beograd.⁷⁸ Takimi mes Martinit dhe Tuk Jakovës, ministrit shqiptar në Beograd rezultoi zhgënjyes për diplomatit italian. Ai u shkruante eprorëve se takimi ishte

⁷⁴ *AMPJ*, V. 1948, D. 146, fl. 121. Relacion mbi riatdhesimin e italianëve nga Shqipëria.

⁷⁵ *Po aty*, fl. 55. Radiogram shifër i legatës shqiptare në Beograd për MPJ-në, nr. 100/3, 29 mars 1948.

⁷⁶ *Po aty*, fl. 69. Radiogram i legatës shqiptare në Beograd për MPJ-në, nr. 100/XI, 14 prill 1948.

⁷⁷ S. Stallone, *Prove di diplomazia adriatica ...*, 220.

⁷⁸ *I Documenti Diplomatici Italiani*, Decima Serie: 1943-1948, vol. VII (7 - 15 dicembre 1947-7 maggio 1948), a cura di Pietro Pastorelli (Roma: Istituto Poligrafico e Zecca dello Stato, 2000), dok. nr. 549 (680-681). Ministri në Beograd Martino për ministrin e Jashtëm, Sforza, 3 janar 1948.

karakterizuar nga “njëfarë ftohtësie”, çka e bëri Martino-n të pohonte se marrëdhëniet mes dy vendeve gjendeshin në një “rrugicë qorre”.⁷⁹

Tirana priste që riatdhesimi i fillimvitit 1948 të shoqërohej me akte të vullnetit të mirë edhe nga qeveria italiane, çka nuk ndodhi. Roma vijonte të mos i përgjigjej kërkesës së Shqipërisë për të dërguar një delegacion për të negociuar çështjen e restitucioneve të objekteve arkeologjike dhe sendeve me vlerë për trashëgiminë shqiptare që gjendeshin në Itali, si dhe vijonte të heshte për kthimin e “kriminelëve të luftës”. Në maj të 1948-s, qeveria shqiptare, nëpërmjet përfaqësisë së saj në Beograd, i dërgoi një notë ambasadës britanike, në të cilën kërkoi ndërhyrjen e katër fuqive për zgjidhjen e çështjes së restitucioneve. Më herët, një notë e ngjashme ishte bërë edhe për çështjen e kthimit të “kriminelëve të luftës”.⁸⁰ Pas një komunikimi mes britanikëve, amerikanëve, francezëve, nga njëra anë, dhe sovjetikëve nga ana tjetër me qeverinë italiane, palët në pozicione krejt të ndryshme, konkluduan se çështjet, në zbatim të Traktatit të Paqes, duhej të zgjidheshin me marrëveshje bilaterale.⁸¹

Tensionimi dhe, më pas, ndërprerja e marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, u konsiderua si një moment i përshtatshëm nga Roma për të rifilluar përpjekjet për të stabilizuar marrëdhëniet mes dy vendeve. Farnezina gjeti një tjetër kanal diplomatik për të negociuar mbi çështjen. Më 16 korrik 1948, përfaqësuesi italian në Sofje, Guarnaschelli-i i kërkoi një takim përfaqësuesit shqiptar, Teodor Heba ku, krahas çështjes së riatdhesimit të italianëve, i shprehu dëshirën e qeverisë italiane për të rivendosur marrëdhëniet diplomatike.⁸² Takimi qartazi një iniciativë personale e Hebës, surprizoi Romën dhe shkaktoi pakënaqësi të dukshme në Tiranë. Në disa komunikime të mëparshme, MPJ-ja kishte porositur diplomatët në Sofje për të evituar kontaktet me kolegët italianë. Ajo e qortoi Hebën për këtë veprim të nxituar. Sipas saj, kërkesat shqiptare karshi Italisë mbështeteshin “në Traktatin e Paqes, prandaj nuk ka nevojë për ndërmjetësime. Ju duhet të kuptoni interpretimin e armiqve në këtë

⁷⁹ S. Stallonte, *Prove di diplomazia adriatica ...*, 222.

⁸⁰ AMPJ, V. 1948, D. 144, fl. 7. Relacion mbi marrëdhëniet e Shqipërisë me Italinë nga çlirimi i vendit deri sot.

⁸¹ S. Stallonte, *Prove di diplomazia adriatica ...*, 223-224.

⁸² AMPJ, V. 1948, D. 143, fl. 1-3. Relacion i ministrit shqiptar në Sofje, T. Heba, për MPJ-në, 16 korrik 1948.

situatë nga kontakte të tilla, prandaj të mos përsëriten”.⁸³ Ministri shqiptar u thirr në Tiranë dhe qëndroi aty për gati dy muaj.

Për Tiranën, me Italinë “neofashiste” të De Gasperi-t, e cila “nën diktatin e qeverisë së Washington-it dhe për interesat e saj imperialiste” vijonte të “ndiqte kundra vendit tonë një politikë armiqësore”, nuk ishte koha për të vendosur marrëdhënie diplomatike.⁸⁴ Ajo çka i interesonte qeverisë shqiptare ishte zbatimi i Traktatit të Paqes, pra dhënia e dëmshpërblimeve, restitucionet e sendeve me vlerë dhe dorëzimi i “kriminelëve të luftës”. Në sytë e Tiranës zyrtare vendosja e marrëdhënieve nuk do ta lehtësonte këtë proces, pasi edhe me shtete të tjera me të cilat Italia kishte marrëdhënie diplomatike ende nuk ishin nënshkruar marrëveshje në zbatim të Traktatit të Paqes.⁸⁵ Autoritetet shtetërore dhe partiake shqiptare e interpretonin kërkesën e Farnezinës, si një dëshirë për të përfituar nga situata në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave për të ndërhyrë, ashtu siç kishte bërë edhe në të kaluarën, në punët e brendshme të Shqipërisë.

Nxitimi i Hebës u shfrytëzua nga diplomacia italiane për të shtuar presionin për kontakte. Roma ishte e gatshme të vendoste marrëdhënie me Shqipërinë, për sa kohë ajo nuk do ta kushtëzonte rifillimin e tyre me kthim të “kriminelëve të luftës”, apo çështjen e dëmshpërblimeve.⁸⁶ Më 29 tetor 1948, ministri italian në Sofje pas kërkesave të përsëritura arriti, më në fund, të takonte përfaqësuesin shqiptar në Sofje, i cili kishte marrë instruksione nga qendra për ta dëgjuar por pa marrë asnjë angazhim.⁸⁷ Sërish fokusi i takimit ishte çështja e riatdhesimit, duke e konsideruar atë si parakusht për plotësimin e kërkesës së qeverisë shqiptare mbi dërgimin në Itali të një komisioni për pasuritë shqiptare. Ai ripërsëriti premtimin që De Gasperi kishte bërë në fillim të vitit se, specialistët italianë që kërkonin të riatdhesoheshin, do të zëvendësoheshin me të tjerë. Duke kuptuar ndjeshmërinë e qeverisë shqiptare në këtë drejtim, ministri shtoi

⁸³ *Po aty*, fl. 4. Radiogram i MPJ-së për legatën shqiptare në Sofje (ministrit), 17 korrik 1947.

⁸⁴ *Po aty*, V. 1948, D. 144, fl. 8-9. Relacion mbi marrëdhëniet e Shqipërisë me Italinë nga çlirimi i vendit deri sot.

⁸⁵ *Po aty*, fl. 8. Relacion mbi marrëdhëniet e Shqipërisë me Italinë nga çlirimi i vendit deri sot.

⁸⁶ S. Stallone, *Prove di diplomazia adriatica ...*, 227.

⁸⁷ *AMPJ*, V. 1948, D. 151, fl. 18. Radiogram shifër i MPJ-së për legatën shqiptare në Sofje, nr. 462/9 rez., 1 tetor 1948.

se do të ndërmjetësohej me anë të PKI-së për të gjetur në radhët e saj specialistë që mund të dërgoheshin në Shqipëri.⁸⁸ Gjithashtu u propozua edhe mundësia për të arritur një marrëveshje të ngjashme me atë Palermo-Hoxha.⁸⁹ Ndjeshmëria që shkaktonte çështja e riatdhesimit të italianëve në opinionin publik në Itali, detyroi edhe PKI-në dhe Shoqatën Ndërkombëtare të Punës, një shoqatë sindikaliste e lidhur me të majtën ndërkombëtare për të shtuar presionin mbi qeverinë shqiptare. Autoritetet në Tiranë nuk ishin kundër riatdhesimit të italianëve të mbetur në vend. Tanimë specialistët italianë mund të zëvendësoheshin me të tjerë nga vendet e Lindjes komuniste. Ajo dëshironte ta përdorte riatdhesimin si mjet kompensimi për të përfitur ndonjë lëshim nga qeveria italiane.⁹⁰

Vetë italianët që gjendeshin në Shqipëri kishin humbur durimin dhe mezi prisnin të riatdhesoheshin. Qeveria shqiptare po merrte gjithnjë e më shumë raporte se specialistët dhe teknikët italianë nuk kishin pranuar të nënshkruanin në masë të madhe kontratat e punës për vitin e ardhshëm dhe “pothuaj pa përjashtim kërkojnë të riatdhesohen”.⁹¹ Sipas një promemorie të MPJ-së për KQ të PPSH-së, vihej në dukje se vetëm 31 nga 289 italianë kishin pranuar të nënshkruanin kontratat. Si rezultat, MPJ-ja këshillonte që të zgjidhej çështja e riatdhesimit dhe të bëhej zëvendësimi i tyre me specialistë nga vendet e demokracive popullore.⁹²

Në fillim të vitit 1949, qeveria shqiptare pati një ndryshim humori në marrëdhënie me Italinë. Më 22 mars 1949, gjatë një bisede të Enver Hoxhës me ministrin e Jashtëm sovjetik, Andrej Vishinski, shtroi në formë pyetjeje, nëse do të ishte oportune në këtë situatë ndërkombëtare vendosja e marrëdhënieve mes Italisë dhe Shqipërisë. Për drejtuesin e shtetit shqiptar vendosja e marrëdhënieve mund të nxiste kontaktet ndërmjet “reaksionit të brendshëm edhe atij ndërkombëtar”, por, nga ana tjetër, qeveria shqiptare do të kishte mundësi të merrte të dhëna mbi “veprimtarinë armiqësore që zhvillohej në territorin e Italisë kundër

⁸⁸ *Po aty*, fl. 25-27. Relacion i të Ngarkuarit me Punë të Shqipërisë në Sofje, Jovan Antoni, për MPJ-në, 29 tetor 1948.

⁸⁹ S. Stallone, *Prove di diplomazia adriatica ...*, 229.

⁹⁰ *AMPJ*, V. 1948, D. 146, fl. 122-123. Relacion i MPJ-së mbi riatdhesimin e italianëve.

⁹¹ *Po aty*, fl. 33-34. Relacion i seksionit V të MPJ-së, në lidhje me kontratën e punës që italianët nuk duan ta përsërisin, pa datë.

⁹² *Po aty*.

Shqipërisë”.⁹³ Çështja e rivendosjes së marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Italisë u diskutua edhe gjatë takimit të Hoxhës me Stalinin. Kreu i shtetit shqiptar shkruan në kujtimet e tij se ishte Stalini që e kishte nxitur për të rivendosur marrëdhëniet me Italinë, duke e këshilluar për të “marrë masa për t’u mbrojtur nga veprimtaria e fashistëve italianë”.⁹⁴

Menjëherë pas këtij takimi, Tirana instrukttoi ministrin e saj në Sofje për t’i bërë me dije homologut italian se qeveria shqiptare do t’i përgjigjej pozitivisht kërkesës për vendosjen e marrëdhënieve. Paraprakisht u ra dakord për një formulë lakonike, nëpërmjet së cilës do të njoftohej rifillimi i marrëdhënieve.⁹⁵ Më 2 maj 1949, me ndërmjetësinë e Bullgarisë dhe me “bekimin” e BRSS-së, u arrit vendosja e marrëdhënieve diplomatike ndërmjet dy vendeve. Ministër i RPSH-së në Itali u emërua Zenel Hamiti, ish-drejtues i formacioneve ushtarake të UNÇ-së, por pa asnjë eksperiencë në diplomaci. Italia caktoi si ministër të saj në Shqipëri një diplomat karriere, Omero Formentini.

Vendosja e marrëdhënieve ishte më shumë një veprim taktik në shërbim të interesave gjeopolitikë të të dyja superfuqive të Luftës së Ftohtë, sesa rezultat i përmirësimit të marrëdhënieve. Megjithatë, ajo u hapi rrugën kontakteve të drejtpërdrejta në diskutimin e çështjeve që shqetësonin të dyja palët. Ndikim pozitiv pati rivendosja e marrëdhënieve, veçanërisht në zgjidhjet përfundimtare të çështjes së riatdhesimit të italianëve. Gjithsesi, vendosja e marrëdhënieve nuk mundi të ndryshojë as perceptimet dhe dyshimet e palëve ndaj njëra-tjetrës, as të normalizonte situatën ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë, e cila mbeti e tensionuar deri në mes të viteve 50-të. Për autoritetet e Tiranës, Italia ishte fqinj imperialist, i cili vijonte të rrezikonte sovranitetin e vendit. Italia kërkonte të ruante pozicionin e një fuqie të madhe, e cila, ndonëse nuk ushqente më ndjenja imperialiste, sërish do të dëshironte të kishte një pozicion të privilegjuar te fqinja e saj e vogël, e dobët, por shumë kryeneçe.

⁹³ “Nga ditari i A. Ja. Vishinkit. Pritja e Enver Hoxhës lidhur me çështjen e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave etj., Moskë, 22 mars 1949”, në Hamit Kaba & Ethem Çeku, *Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse 1946-1962*, (Prishtinë: Brezi 81, 2011), 90.

⁹⁴ Enver Hoxha, *Me Stalinin* (Tiranë: 8 Nëntori, 1979), 114.

⁹⁵ *AMPJ*, V. 1949, D. 149, fl. 3. Radiogram shifër e MPJ-së për ministrin shqiptar në Sofje, Vasil Konomi, 15 prill 1949.

SONILA BOÇI

Institute of History / Academy of Albanological Studies, Tirana
sonilaboci23@gmail.com

*S u m m a r y***ALBANIA AND ITALY FROM THE END OF THE WORLD WAR II UNTIL DHE
ESTABLISHMENT OF THE DIPLOMATIC RELATIONSHIP (1945-1949)**

Albania and Italy both emerged from World War II with an unclear international status. Albania had been one of the first victims of the Axis. The resistance of the Albanians against the Axis armies (Fascists first and then the Nazis) was recognized by the Allies, but the lack of a government in exile and the international non-recognition of the provisional government that emerged from the second meeting of the National Liberation Council in Berat left the status of the continuity of the Albanian state in a precarious situation. Italy, on the other hand, had been one of the Axis countries, but the commitment of the Italians during the years 1943-1944 in the resistance against Hitler's Germany gave it the status of a defeated country at the end of the war. For this reason, the Allies, especially in the West, were willing to make some concessions. Controlled by the Allies in many aspects of its foreign policy, postwar Italy was trying to regain its place in the European geostrategic configuration. The years that the article covers are very important for both countries' attitudes and policies towards each other. The purpose of the article is to analyze the path that Italy and Albania followed in trying to restore diplomatic relations in a world emerging from an armed conflict, which was rapidly moving towards ideological polarization. The article argues that the positioning of Italy and Albania the two opposing fronts of the Cold War conditioned the relations between them.

